

Më të rëndësishmet shkurtimisht



Për çfarë duhen tabletat e jodurit?

Jodur-kaliumit 65 SERB Tabletat janë tableta të jodurit me dozë të lartë, të cilat përdoren vetëm në raste emergjente sipas udhëzimit të autoriteteve. Në rastet e një aksidenti të rëndë në një central bërthamor mund të çlirohet ndër të tjera edhe jodur radioaktiv në ambient. Ky jodur radioaktiv thithet nëpërmjet ajrit dhe grumbullohet në gjëndrën tiroide. Tabletat e jodurit parandalojnë grumbullimin e jodurit radioaktiv në gjëndrën tiroide.

Si duhet të ruhen tabletat e jodurit?

Tabletat e jodurit duhet të ruhen dhe të mbahen në paketimin origjinal në temperaturë dhome (15–25 °C). Ju lutemi, mbani tabletat larg fëmijëve.

Kur urdhërojnë autoritetet furnizimin dhe marrjen e tabletave të jodurit?

Nëse gjatë një aksidenti të rëndë në një central bërthamor ekziston rreziku që mund të çlirohen materie radioaktive, popullata alarmohet dhe informohet përmes sirenave, radios dhe mediave të tjera. Tabletat e jodurit merren për herë të parë pas urdhëresës përkatëse të autoriteteve – përkatësisht me sasi të bollshme lëngjesh. Autoritetet përcaktojnë gjithashtu nëse duhet të merren tabletat disa herë.

Përse shpërndahen tabletat e jodurit si një masë parandaluese?

Ju jetoni brenda rrethit prej 50 kilometrash afër një centrali bërthamor. Në mënyrë që ju në rast incidenti të mund t'i merrni në kohë tabletat e jodurit, ato do t'ju dërgohen automatikisht në shtëpinë tuaj – si një masë parandaluese dhe falas. Ju merrni qëllimisht më shumë tableta sesa janë të nevojshme për një person, në mënyrë që të mund të furnizoni edhe të afërmit ose vizitorët që nuk kanë marrë ose nuk kanë me vete ndonjë tabletë joduri.

Kush duhet t'i marrë tabletat e jodurit?

Tabletat e jodurit janë një masë efektive për fëmijët, adoleshentët, shtatzënat dhe personat deri në 45 vjeç për parandalimin e kancerit të tiroides. Për personat mbi 45 vjeç marrja e tabletave të jodurit nuk rekomandohet më. Nëse ju jeni mbi 45 vjeç dhe konsideroni të merrni në rast incidenti tableta joduri, mund të merrni më shumë informacion në ambulancën e mjekut, në farmaci ose në drogeri.

Si i përdorni ju tabletat e jodurit?

Shihni fletën shoqëruese në kuti.

Informacione të mëtejshme:

www.jodtabletten.ch

